



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E HARTIMIT T PROJEKTEVE, MONITORIMIT TE INVESTIMEVE DHE**  
**SHERBIMEVE**

**RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI “Rikonstruksion I rruges "Dukas - Kuqar - Manekaj – Rusinje”**

- TË PËRGJITHSHME

- HYRJE

Qyteti i Patosit përfshihet në rrethin e Fierit. Ai është qyteti i dytë më i madh pas Fierit, për nga numri i banorëve, në Qarkun e Fierit. Patosi ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit i shtrirë përgjatë vargut kodrinor cili ndan Fushën e Myzeqese nga lugina e lumit Gjanica. Ky varg kodrinor vazhdon në formë harku përgjatë rrugës Patos-Fier duke përngjarë me një amfiteater natyror. Ai është pjesë e kodrave të Mallakastrës së poshtme të cilat vazhdojnë drejt Jugut deri në lumin Vjosë.

Lartësia mesatare e tyre është rreth 200–300 m e cila vjen duke u ulur drejt Patosit derisa zhyten në fushën e Myzeqese. Pika më e lartë e rajonit ndodhet në kodrën e Margëlliçit me kuote 320 m mbi nivelin e detit. Përpara qytetit drejt veriut dhe veri-perëndimit shtrihet fusha e Myzeqesë ndërsa drejt verilindjes fusha e Rroskovecit.



Sipërfaqja sipas relievit ndahet në : Fushore 718 ha dhe Kodrinore 1488 ha. Prane qytetit degëzohen rruga Fier-Gjirokastër dhe Fier-Berat të cilat kanë ndikuar në shtrirjen dhe zhvillimin e rajonit. Klima është tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Kjo situatë ndikohet nga masat ajrore detare për shkak të distancës relativisht të shkurtër nga deti Adriatik (rreth 25 km).

Nga ana lindore dhe jugore, vargmalet e larta e pengojnë depërtimin e klimës së ftohtë kontinentale. Temperatura mesatare vjetore luhet në 14-15 °C ndërsa temperatura e janarit rreth 5 °C. Reshjet bien kryesisht në formë shiu ndërsa dëbora është dukuri e rrallë.

Gjatë verës bien vetëm 1/10 e reshjeve vjetore gjë që shtron nevojën e ujitjes së tokave bujqësore. Për këtë arsye janë ndërtuar disa liqene artificiale si ujëmbledhësi i Zharrzës, Lalarit, Rrozhdiës etj.

## 1. Vendndodhja

Objekti “Rikonstruksion I rruges Dukas – Kuqar – Manekaj – Rusinje” shtrihet në lindore të qytetit të Patosit. Kjo është një rruga rurale që lidh banoret dhe bizneset nga lagja Dukas me fshatin Kuqar, Manekaj dhe duke perfunduar në fshatin Rusinje, pjesë e Njesisë Administrative Ruzhdië, Bashkia Patos. Ky segment rrugor shtrihet në një gjatësi prej 6.3 km.

Koordinatat e projektit janë :

Sipas KRGJSH:

- N-468811.916 E-4506834.82
- N-472864.098 E-4503896.871

Sipas Gauss-Kruger:

- 4384413.257 4507828.841
- 4388443.634 4504803.680

## 2. Përshkrimi I situatës ekzistuese

Kjo rruge lidh fshatrat Maneka , Kuqar dhe Rusinje me rrugen kryesore Patos- Ruzhdie. Me ndertimin e ketij segmenti rrugor do te kene akses ne tregjet e produkteve bujqesore shume fermere dhe banore te cilet kane tokat apo



biznese bujqesore pergjate kesaj rruge. Do te shkurtohet koha per ardhjen e produkteve bujqesore prane tregjeve te Fierit dhe Roskovecit. Shume fermere kane ngritur biznese si famбрика vaji apo pika te vogla te grumbullimit te produkteve bujqesore. Mungesa e rruges se asfaltuar ka bere qe te kemi pengesa ne arritjen e tregjeve per produktet qe prodhohen nga fermeret e zones.

Gjendja e rruges ne te gjithë gjatesine e saj eshte jo e mire. Pervec zonave te banuara, ne te gjithë gjatesine e rruges mungojne shtresat e siperme asfaltike te rruges. E gjithë rruga eshte e shtruar vetme me cakell. Ne te dyja anet e rruges ne shumicen e gjatesise se saj mungojne kanalet e kullimit te ujrave dhe bimesia (kryesisht ferra) ka shtrire rrenjet deri ne buze te rruges. Gjate gjithë gjatesise se rruges, per shkak te mungeses se largimit te ujrave siperfaqesore jane krijuar gropa te shumta te cilat ne periudhen e dimrit kthen ne pellgje uji te cilat demtojne akoma me shume shtresat e pakta te rruges. Ne shume vende nevojiten vepra arti (tombino Ø400-1000) per kalimin e ujrave ne rruge.



Mungesa e investimeve te qendrushme per sistemimin dhe asfaltimin e kesaj rruge ka penguar mirembajtjen e rruges dhe shkakua kryesor I amortizimit te saj duke bere qe gjendja e saj te vazhdoje te perkeqesohet. Gjeresia aktuale e rruges nuk lejon shkembimin lirshem midis dy automjeteve. Gjendja e keqe fizike e rruges behet pengese per qarkullimin lirshem te banoreve te zones ne kete segment rrugor. Kerksa e vazhdueshme e banoreve te zones ka qene asfaltimi te gjithe gjatesise se saj sipas standarteve te rrugeve urbane.

### 3. Pershkrimi I projektit

Projekti parashikon nderhyrje ne te gjithe kete segment. Gjatesia totale e rruges eshte mbi 6.3 km. Elemente perberes kryesore te ketij segmenti jane trupi I rruges I cili ka nje gjeresi asfalti prej 5.5 ml e cila bashke me kunetat anesore ne te duja anet e saj shkon ne total 6.5 ml. Gjithashtu elemente tjeter kryesore eshte sistemi I kullimit I cili perbehet nga nje kanal kullues me gjeresi 70 cm dhe qe ruan nje distance prej 1 ml nga perfundimi I kunetes anesore.

Elemente shtese do te kete vetem ne zonat e banuara, gjatesia e te cilave shkon ne reth 2.5 km ne total dhe eshte e mobiluar me trotuare ngate dyja krahet e segmentit, ku secili prej tyre ka nje gjatesi nga 1.5 deri ne 2ml, ne varesi te terrenit te cilat bejne te mundur kalimin pa veshtiresi te kalimtareve te zones. Parashikohet shtrim me pllaka I trotuarit, gjithashtu vendosja e ndricimit dhe gjelberimi I zones se banuar te perfshire ne project.

Shtresa t e siperme te trupit te rruges jane shtresa me asfaltobeton me trashesi  $t=4$  cm dhe shtresa me binder me trashesi  $t=6$  cm. Te dyja keto shtresa do te behen me matrial grui te thyer me rezistence ne shtypje mbi  $1.70 \text{ daN/cm}^2$ . Ne neshtresat e rruges do permendim shtresen me stabilizantit me trashesi  $t=15$  cm me material guri te thyer me madhesi te kokrizave 0-31.5 mm, dhe shtresa me cakell te thyer mbetyrine kavoje me trashesi  $t=20$  cm. kjo shtrese do te sherbeje edhe per mbushjen e gropave te ndryshme te cilat gjenden ne trupin e rruges. Per pjeset e rruges ne te cilat jane te demtuara duhet te behet hapja e vendit te demtuar dhe largimi I baltes dhe/ose shkaktareve te tjere te ketyre demtimeve. Ne disa vende kemi reshqitje te formacioneve. Per stabilizimi ne ketyre zonave me shkarje do te ndertohen mure mbajtese me gabiona me rrjete teli dhe

gure. Vendosja dhe gjatesia e ketyre mureve me gabiona dhe gure do te behet sipas te dhenave ne project.

Ne te dyja anet e rruges do te kemi bankina me material stabilizanti. Ne pjesen e brendeshme te qendrave te banuara bankina do te zevendesohet me kunete betoni.

Ne pjesen e qendrave te banuara do te behen edhe trotuaret per kembesoret. Punimet per ndertimin e trotuareve perfshijne ndertimin e nje shtrese betoni per fiksimi ne bordurave te parapergatiture te betonit. Per shtresen e sipërme te trotuarit do te perdoren pllaka cimentoje me boje veteshtrenguese. Ne ane te trotuareve per kufizimin e tij do te perdoren bordure betoni te parapergatitura me permasa 15x25 cm.

Ne qendrat e banuara do te kemi kanalizimin e ujrave siperfaqesore nga reshjet e shiut. Kanalizimi do t ebeht me anen e kanalizimit te ujrave te bardha dhe pusetave shimbledhese.

Gjithashtu me qendrat e banuara do te instalohet edhe rrjeti I ndricimit.. parashikohen te vendosen shtylla ndricimi dhe ndricues LED.

Pas perfundimi te shtrimit te rruges do te behet edhe sinjelistika vertikale dhe horizontale. Do te vendosen tabela per emertimin e qendrave te banuara dhe tabela per sinjalistiken rrugore.

Pergatiti:  
**Ing.Silvana MICI** **ing.Arben MANOKU**

Foto te gjendjes ekzistuese te rruges



